



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: LUMNIJE BERISHA B.I.
Emri tregtar: N.SH. "FESTINA"
NUI: 811385948
Pronari: Lumnije BERISHA
OSHMA: TV Festina
Adresa: Rr/Driton Islami, p.n., Ferizaj

Emri i Biznesit: VLLZNM JAKUPI BI.
Emri tregtar: N.SH. "ALB Production"
NUI: 811067588
Kandidati për pronar: Vllaznim JAKUPI
OSHMA: TV Festina
Adresa: Rr/ Driton Islami, p.n., Ferizaj

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së TV Festina, me seli në Komunën e Ferizajit



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. TV Festina është Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me mbulim lokal, i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të programeve televizive në gjuhën shqipe, me seli në komunën e Ferizajit.
3. Më datën 23 mars 2021, pronarja e TV Festina ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës nga biznesi individual Lumnije Berisha B.I., me Numër Unik Identifikues 811385948 (me emër tregtar N.SH. "FESTINA") me pronaren znj. Lumnije Berisha te biznesi individual Vllaznim Jakupi BI., me Numër Unik Identifikues (NUI) 811067588 (me emër tregtar N.SH. "ALB Production") dhe me pronar z. Vllaznim Jakupi.

Arsyetim

4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".
5. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së*".

6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që:
“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”
7. Me anë të kërkesës për ndryshimin e pronësisë së TV Festina, pronarja aktuale ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim janë çështjet financiare.
8. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të TV Festina ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Gjithashtu, kandidati ka deklaruar se ka përvojë të gjatë pune në televizion.
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të TV Festina, angazhimin e stafit profesional, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare kandidati për pronar ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare.
10. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, zotimet për angazhimin e stafit profesional si dhe përvojën e gjatë të punës në televizion të kandidatit, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së TV Festina është në interes të publikut.
11. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

12. Komisioni në takimin e tij, të mbajtur më datën 26 maj 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së TV Festina dhe bartjen e licencës nga biznesi individual Lumnije Berisha B.I., me Numër Unik Identifikues 811385948 (me emër tregtar N.SH. “FESTINA”) me pronare znj. Lumnije Berisha te biznesi individual Vllaznim Jakupi B.I., me Numër Unik Identifikues (NUI) 811067588 (me emër tregtar N.SH. “ALB Production”) dhe me pronar z. Vllaznim Jakupi
13. Komisioni vendos që, përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të TV Festina nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.
14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



26.05.2021
datë